



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 19 prill 2022
Nr.ref.:RK 1982/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI183/21

Parashtrues

Ejup Koci

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave në
Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj dhe Gjykatën
Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, përkitazi me lëndën
C.nr. 256/2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ejup Koci (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) me vendbanim në Skenderaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike por konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C. nr. 256/2018] që është zhvilluar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj dhe procedurën që është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C.nr. 256/2018] në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj dhe Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, respektivisht. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenit 24 [Barazia para Ligjit], paragrafit 2 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 11 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 14 tetor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj.
7. Më 18 tetor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 9 nëntor 2021, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi informatat përkatëse përkitazi me procedurën e zhvilluar nga data e transferimit të këtij rasti në këtë degë.
9. Më 12 nëntor 2021, përmes postës elektronike, Gjykata pranoi përgjigjen e gjyqtarit mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri.

10. Më 28 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës përmes postës elektronike në Gjykatë dorëzoi një kërkesë për informatë në lidhje me statusin e kërkesës së tij.
11. Po të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi parashtruesit të kërkesës informatën se kërkesa e tij është në procedurë të shqyrtimit.
12. Më 2 shkurt 2022, Gjykata shqyrtoi Raportin Paraprak të propozuar nga gjyqtarja raportuese dhe njëzëri vendosi që shqyrtimi i kërkesës me plotësime shtesë të shtyhet për një seancë tjetër të Gjykatës.
13. Më 25 shkurt 2022, Gjykata i dërgoi Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK) njoftimin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkesë për përgjigje ndaj pyetjeve si në vijim:

Cila është strategjia apo veprimet e ndërmarra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës përkitazi me shqyrtimin e lëndëve para gjykatave të rregullta brenda një afati të arsyeshëm kohor, garanci kjo e përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës ?; dhe

Bazuar në rregullat apo procedurat e përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, specifikisht në kuptim të përcaktimit të radhës së shqyrtimit të rasteve të regjistruara në gjykatat e rregullta, si trajtohet çështja e radhës së shqyrtimit të lëndëve, të cilat më vendim të gjykatës përkatëse transferohen për shqyrtim dhe gjykim nga një degë e Gjykatës në degën tjetër të gjykatës së njëjtë?

14. Më 7 mars 2022, KGJK dorëzoi përgjigjet e tij ndaj pyetjeve të Gjykatës.
15. Më 14 mars 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesë për përsheptimin e shqyrtimit të kërkesës së tij.
16. Më 23 mars 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesë për informacion rreth statusit të kërkesës së tij. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës se kërkesa e tij është duke u shqyrtuar nga Gjykata.
17. Më 30 mars 2022, Kolegji shqyrtoi Raportin Paraprak të propozuar nga gjyqtarja raportuese, dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, me shumicë votash, vendosi që kërkesën e parashtruesit të kërkesës ta shpallë si të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

18. Parashtruesi i kërkesës parashtron kërkesë për herë të pestë në Gjykatë.
19. Kërkesat e tij të parashtruara më 8 shtator 2017 [kërkesa KI109/17] dhe më 22 tetor 2018 [kërkesa KI161/18] respektivisht, nuk ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret.
20. Më 17 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e tij të tretë, të regjistruar në Gjykatë me numër KI64/19, përmes të cilës kontestoi

Aktvendimin [C.nr. 204/2015] të 27 prillit 2017 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Skenderaj, me ç'rast ishte ndërprerë procedura kontestimore dhe parashtruesi i kërkesës ishte udhëzuar që të fillojë procedurën për përcaktimin e trashëgimisë, në kuadër të procedurës jo-kontestimore. Shqyrtimi i trashëgimisë u konsiderua si çështje paraprake në mënyrë që të vazhdohej me shqyrtimin e lëndës në procedurë kontestimore. Në lidhje me këtë të fundit, më 27 prill 2018, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, përmes Aktvendimit [CT.nr.33/2018], përveç parashtruesit të kërkesës, shpalli trashëgimtarë të pronës së kontestuar edhe A. Sh. K., dhe M.Sh.K. Si rezultat i këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës më 26 korrik 2019, në Gjykatë kishte parashtruar kërkesën për tërheqjen e kërkesës me numër KI64/19. Gjykata, në këtë rast, vlerësoi se nuk ka ndonjë arsye bindëse për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Aktvendimit të kontestuar dhe rrjedhimisht miratoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për tërheqjen e kërkesës me numër KI64/19.

21. Më 30 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e tij të katërt të regjistruar në Gjykatë me numër KI104/20, përmes të cilës kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë të kohëzgjatjes së procedurës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, përkitazi me gjykimin e lëndës [C.nr.204/2015], e që i referohet procedurës jo-kontestimore dhe asaj kontestimore para kësaj gjykate. Më 25 shkurt 2019, kjo lëndë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj kishte marrë numrin e ri rendor [C.nr.256/2018]. Gjykata konsideroi se periudha që duhej të merrej parasysh ishte ajo që fillonte nga data e parashtrimin të kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj deri në parashtrimin e kërkesës së tij në Gjykatë, e cila përfshinte periudhën prej 4 (katër) vjet, 11 (njëmbëdhjetë) muaj e 26 (njëzetë e gjashtë) ditë. Gjykata, në rastin KI104/20, vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar pretendimin se ecuria e procedurës për vendosjen e rastit të tij ka rezultuar në tejzgjatje dhe moszgjidhje të rastit brenda një afati të arsyeshëm kohor, e garantuar me nenin 31, paragrafin 2 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejta e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ). Rrjedhimisht, më 22 mars 2021, Gjykata shpalli kërkesën e parashtruesit të kërkesës të papranueshme si qartazi të pabazuar në bazë kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Faktet e rastit në lidhje me kërkesën e tanishme

22. Gjykata fillimisht vë në pah se faktet e rastit të kërkesës së tanishme, ndërlidhen edhe me faktet e rastit të kërkesës KI104/20, përkatësisht i referohen procedurës kontestimore dhe asaj jo-kontestimore të zhvilluara në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, të cilat në mënyrë të përmbledhur do ti reflektojnë si në vijim.
23. Gjykata rikujton se më 7 korrik 2015, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj për vërtetim të kufirit (mezhdës) të paluajtshmërisë në mes të dy paluajtshmërive fqinje. Në kërkesëpadinë e tij, parashtruesi i kërkesës specifikoi se H.K kishte uzurpuar një pjesë të paluajtshmërisë së tij dhe rrjedhimisht i kërkoi Gjykatës Themelore që

ky i fundit të lirojë *“këtë pjesë të uzurpuar të paluajtshmërisë së [parashtruesit të kërkesës].”*

24. Më 27 janar 2017, si rezultat i kërkesës së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj për plotësim dhe saktësim të padisë, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në këtë gjykatë padinë e tij të plotësuar dhe në vijim të zhvillimit të procedurës dorëzoi kërkesë për përshpejtim të procedurës së shqyrtimit të rastit të tij.
25. Më 27 prill 2017, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj përmes Aktvendimit [C.nr.204/2015] ndërpreu procedurën kontestimore të parashtruesit të kërkesës dhe e udhëzoi atë që të fillojë procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë në procedurë jo-kontestimore. Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj parashtruesin e kërkesës e udhëzoi në procedurë jo-kontestimore për arsye se: *“përveq [parashtruesit të kërkesës] ka edhe trashëgimtarë tjerë të radhës së parë i cili raporte ka lidhje direkte me qështjen e kontestit dhe pasi të dihen pronarët (trashëgimtarët) në parcelën e cila është qështje shqyrtimi mund të zhvillohet procedura gjyqësore sipas rregullave të procedurës kontestimore.”*
26. Aktvendimin e lartcekur, të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj 27 prillit 2017, parashtruesi i kërkesës e kishte kontestuar edhe përmes kërkesës së tij të dorëzuar në Gjykatë, dhe të regjistruar me numër KI64/19.
27. Më 27 prill 2018, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj në procedurë jo-kontestimore përmes Aktvendimit [Ct.nr.33/2018] i shpalli trashëgimtarë të pronës së kontestuar: parashtruesin e kërkesës; A. Sh. K., dhe M.Sh.K.
28. Më 17 maj 2018, si rezultat i Aktvendimit të lartcekur [Ct.nr.33/2018] parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj parashtrroi kërkesë për rifillimin e procedurës së ndërprerë përmes Aktvendimit [C.nr.204/2015], të 27 prillit 2017. Këtë kërkesë për rifillim të procedurës, parashtruesi i kërkesës e kishte ripërsëritur edhe më 4 qershor 2018 dhe 14 gusht 2018, respektivisht.
29. Më 25 shkurt 2019, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj e njoftoi parashtruesin e kërkesës se lënda e tij është në procedurë të shqyrtimit të gjyqtari i çështjes dhe e njëjta ka numrin e ri rendor [C.nr. 256/2018].
30. Gjatë periudhës së 7 shkurtit 2019 dhe 29 tetorit 2021, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj dorëzoi edhe pesë (5) kërkesa për të kërkuar informacion rreth statusit aktual të lëndës së tij.
31. Më 9 korrik 2019, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj ishte mbajtur seanca e parë përgatitore, e cila ishte shtyrë për shkak të mungesës së adresës së palës së paditur, për të cilin gjykata i kishte kërkuar parashtruesit të kërkesës që të precizojë adresën e tij, në mënyrë që pala e paditur të ftohet në seancë gjyqësore.

32. Më 23 janar 2020, Gjkata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj e njoftoi parashtruesin e kërkesës se rasti i tij është duke u shqyrtuar me prioritet dhe se së shpejti do të caktohet edhe seanca përgatitore.
33. Më 4 shkurt 2020, pas mbajtjes së seancës përgatitore, Gjkata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj nxori Aktvendim përmes të cilit kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta precizojë dhe plotësojë padinë në kuptimin subjektiv dhe vendosi që pala kundërshtare H.K., të ftohet në seancën e radhës.
34. Më 19 shkurt 2020, Policia e Republikës së Kosovës në Gjykatën Themelore kishte dorëzuar të dhënat e adresës së palës së paditur H.K.
35. Më 21 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë: në Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Gjykatën Themelore në Mitrovicë; te gjyqtari mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Skenderaj; dhe te gjyqtari i lëndës A.M. në këtë gjykatë, për shkak të tejzgjatjes së procedurës lidhur me vendosjen e lëndës [C.nr.256/2018] dhe në kontekst të kësaj të fundit, kërkoi edhe përjashtimin e gjyqtarit A.M. nga shqyrtimi i rastit të tij.
36. Më 22 qershor 2020, Gjkata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj ftoi parashtruesin e kërkesës që të paraqitet në këtë gjykatë dhe të paguajë taksën gjyqësore në vlerë prej njëzet (20) euro, në emër të kërkesës së tij, të 21 shkurtit 2021 për përjashtimin e gjyqtarit A.M nga rasti, duke e njoftuar atë se në rast të mos pagesës së taksës gjyqësore nga ana e tij, kërkesa e tij do të konsiderohet si e tërhequr.
37. Më 2 korrik 2020, Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, përmes Njoftimit [GJA nr.5/20], njoftoi parashtruesin e kërkesës që lënda e tij [C.nr.256/2018] duhet të kthehet në procedim te gjyqtari i çështjes A.M për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paguar taksën gjyqësore [të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ NR. 01/2017] përkundër paralajmërimit të 22 qershorit 2020 të kësaj gjykate.
38. Më 13 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës në shkresën e tij drejtuar Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj konfirmoi pranimin e njoftimit përkitazi me detyrimin për pagesën e taksës gjyqësore, dhe në vijim theksoi se *“Sipas këtij vlerësimi te Kryetarit të Gjykatës (i cili është jo ligjor sepse nuk ka bazë ligjore për vlerësim te tillë, sipas nenit 46 të Rregullores Nr.02/2020.te datës 08.07.2020 e cila bazohet në ligjin Nr.06/L-054, por njoftimi nuk krijon pasoja Juridike ndaj paditësit e kurrësi kur nuk i është drejtuar atij por GJTHM-Dega Skenderaj) i mbetet gjyqtarit të lëndës te vendos se A DO TE PROCEDOJ MË TUTJE ME LËNDËN APO TË PARAQES KËRKESË KRYETARIT TË GJTHM PËR VETËTERHEQJE.”*
39. Më 28 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjkata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj që të përshpejtojë zgjidhjen e rastit të tij [C.nr.256/2018].
40. Më 29 shtator 2020, Gjkata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj përmes Aktvendimit [C.nr. 256/2018] vendosi që parashtruesin e kërkesës ta lirojë nga taksa gjyqësore.

41. Në një datë të pasaktësuar, si rezultat i kërkesës së parashtruesit të kërkesës për përjashtimit të gjyqtarit të rastit A.M, ky i fundit i paraqiti Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë kërkesë për përjashtimin e tij nga shqyrtimi dhe vendosja e lëndës [C.nr.256/2018].
42. Më 8 tetor 2020, Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë përmes Aktvendimit [GJA.nr.5/2020] vendosi që të aprovojë kërkesën e gjyqtarit A.M, për përjashtim tij nga shqyrtimi i rastit [C.nr.256/2018], dhe të njëjtën kohë vendosi që kjo lëndë t'i caktohet gjyqtarit tjetër B.F në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri.
43. Përmes Aktvendimit të lartcekur theksohet se: *“Gjyqtar i çështjes [A.M] me datë 27.10.2020 ka dhënë deklaratë, duke konsideruar se kërkesa e [parashtruesit të kërkesës] për përjashtimin e tij nga kjo lëndë është e pabazuar pasi që pretendimet e cekura nga paditësi nuk qëndrojnë, mirëpo duke marrë parasysh dyshimin e [parashtruesit të kërkesës] i cili nga vetja ka formuar bindje i propozon Kryetarit të Gjykatës që ti ketë parasysh pretendimet e [parashtruesit të kërkesës] me qëllim të eliminimit të dyshimit të tij, andaj në bazë të dispozitave të nenit 67 par. (g) të LPK-së konsideron se janë plotësuar kushtet për përjashtimin nga kjo lënd.”*
44. Në vijim, Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, përmes Aktvendimit të tij theksoi se: *“Kryetari i Gjykatës pasi shqyrtoi kërkesën e [parashtruesit të kërkesës] për përjashtimin e gjyqtarit i çështjes nga kjo lëndë dhe deklaratën e gjyqtarit [A.M.], gjeti se paditësi ka krijuar bindje se gjyqtari i çështjes nuk po procedon lëndën pasi që i njëjti ka paraqitur shqetësime lidhur me tejzgjatjen e procedurës për vendosjen e kësaj lënde nga ky gjyqtari i çështjes, e kjo vërtetohet edhe nga deklaratat e gjyqtarit, andaj Kryetari i gjykatës i vlerëson se plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenit 67 par. (g) të LPK-së, që i njëjti të përjashtohet nga procedimi i mëtejshëm i kësaj lënde, e krejt kjo me qëllim të eliminimit të të gjitha dyshimeve të parashkruar nga [parashtruesi i kërkesës], dhe kjo lëndë ti ndahet ndonjë gjyqtari tjetër e në rastin konkret gjyqtarit [B.F.]”*
45. Më 9 tetor 2020, si rezultat i Aktvendimit [GJA.nr.5/2020] të lartcekur të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë lënda [C.nr.256/2018] u dërgua për shqyrtim dhe vendosje në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri.
46. Më 16 shkurt 2021, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj që ta informojë atë lidhur me statusin aktual të rastit të tij pasi që nga pranimi i Aktvendimit [GJA.nr.5/2020] të 8 tetorit 2020, nuk ka pranuar ndonjë informacion për atë rast.
47. Më 25 shkurt 2021, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj njoftoi parashtruesin e kërkesës se, më 9 tetor 2020, lënda [C.nr.256/2018] është dërguar për vendosje në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri.
48. Më 13 prill 2021, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri parashtrroi kërkesë që ta informojë atë lidhur me statusin

aktual të rastit të tij. Të njëjtën kërkesë, parashtruesi i kërkesës e përsëriti edhe më 9 dhe 25 gusht 2021, respektivisht.

49. Më 11 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës njoftoi Gjykatën se deri më 11 tetor 2021, respektivisht deri në datën e parashtrimit të kërkesës së tij në Gjykatë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri nuk ka pranuar asnjë informatë në lidhje me lëndën [C.nr. 256/2018] dhe po ashtu nga e njëjta gjykatë nuk është njoftuar as në lidhje me mbajtjen e seancës gjyqësore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

50. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për tejzgjatje të procedurës së zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj e kishte ngritur edhe në kërkesën e tij në Gjykatë, të regjistruar me numër KI104/20. Megjithatë, edhe në kërkesën e tanishme, parashtruesi i kërkesës sërish pretendon tejzgjatje të procedurës së zhvilluar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj dhe në kontekst të këtij pretendimi specifikon se për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Skenderaj, kjo e fundit ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 21, 22, 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës.
51. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se përkitazi me tejzgjatjen e procedurës së zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj ka parashtruar ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatën e Apelit, te Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe te gjyqtari mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj duke kërkuar nga këta të fundit përshejtimin e zgjidhjes së rastit të tij. Në vijim, parashtruesi i kërkesës sqaron se edhe përkitazi me procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri nga data e transferimit të lëndës së tij në këtë degë nga kjo e fundit ende nuk janë ndërmarrë veprime për zgjidhjen e rastit të tij.
52. Më specifikisht, në lidhje me procedurën e zhvilluar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, në të cilën gjykatë, lënda është dërguar për vendosje më 8 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar arsyetim konkret në lidhje me pretendimin për tejzgjatje të procedurës para kësaj gjykate, por vetëm ka njoftuar Gjykatën se *"1. deri më datën e parashtrimit të kërkesës [11.10.2021] nga GJTHM-Dega në Vushtrri, nuk kam marrë asnjë informatë në lidhje me lëndën C.nr. 256/2018 por as përgjigje në kërkesat e parashtruara GJTHM-dega në Vushtrri (shih provat ne dosjen e kërkesës). 2. Nuk kam marr as thirrje për seancë as ndonjë shkresë me të cilën GJTHM-Dega në Vushtrri njofton se ka ndërmarr ndonjë veprim ligjor në lidhje me lëndën e lartë përmendur."*
53. Në fund, parashtruesi i kërkesës, kërkon nga Gjykata që të nxjerrë vendim, përmes të cilit aprovon kërkesën e tij si të pranueshme dhe vërteton pretendimin e tij për moszgjidhje të rastit brenda afatit të arsyeshëm kohor duke gjetur shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe konventa të tjera ndërkombëtare.

Përgjigja e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri

54. Më 12 nëntor 2021, përmes postës elektronike, gjyqtari mbikëqyrës, A.M., në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, e njoftoi Gjykatën me përgjigjen e gjyqtarit të çështjes, si në vijim: *“si gjyqtar i deleguar me këtë lëndë, për shkak të ngarkesës me lëndë të tjera më me prioritet sesa kjo lëndë, aktualisht jam duke i proceduar lëndët e vitit 2014 dhe se kjo lëndë duhet të presë të shqyrtohet porsa ti vije radha e rregullt”*.
55. Në përgjigjen e gjyqtarit të çështjes drejtuar gjyqtarit mbikëqyrës A.M, i njëjti theksoi se aktualisht është i ngarkuar me një mijë e gjashtë qind e dyzet e shtatë (1647) lëndë dhe se lidhur me lëndën [C.nr. 256/2018] nuk ka ndërmarrë asnjë veprim juridik, si dhe duke pasur parasysh ngarkesën e tij me lëndë, nuk pritet që të marrë ndonjë veprim për arsye objektive të tij.
56. Për më tepër, gjyqtari mbikëqyrës, A.M. e njoftoi Gjykatën që në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, nga marsi i viti 2022 pritet që me lëndë të ngarkohen edhe dy gjyqtarë të përzgjedhur në fushën civile, të cilët janë në fazën e trajnimit fillestar.

Përgjigja e KGJK-së

57. Në shkresën e tij, të 7 marsit 2022, ndaj pyetje të lartcekura të Gjykatës, KGJK u përgjigj si në vijim:

Fillimisht theksojmë qe, edhe pse numri i lëndëve të prapambetura mbetet ende i lartë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në vazhdimësi ka bërë përpjekje që përmes akteve, politikave dhe veprimeve konkrete të ndikojë në uljen e numrit të rasteve ashtu që qytetarët të marrin zgjidhje në rastet e tyre para gjykatave në kohë të arsyeshme.

Më konkretisht, nxjerrja e akteve dhe ndërmarrja e veprimeve konkrete në vijim janë disa nga masat që KGJK ka ndërmarrë me qëllim të uljes së numrit të lëndëve dhe shqyrtimit të tyre në afat të arsyeshëm kohorë.

1. Draft Plani Strategjik për efikasitetin dhe prioritetizimin e lëndëve brenda sistemit të drejtësisë 2022-2024

Këshilli Gjyqësor i Kosovës aktualisht është në hartim të sipër të Planit Strategjik për efikasitetin dhe prioritetizimin e lëndëve brenda sistemit të drejtësisë 2022-2024 .

Synim i këtij Planit strategjik është zhvillimi i një qasjeje praktike, me qëllim të adresimit të çështjes së zvogëlimit përkatësisht zgjidhjes së lëndëve që kanë një afat më të gjatë të pritjes si dhe atyre që përcaktohen për nga natyra si lëndë me prioritet, nëpërmjet këtyre institucioneve.

2. Procesi i rekrutimit të gjyqtareve të rinj

Siç mund të jeni në dijeni, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me nenin 108 të Kushtetutës, Ligjin Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjin Nr.06/L-054 për Gjykatat, Rregulloren Nr. 03/2021 për Rekrutimin,

Provimin, Emërimin dhe Ri-Emërimin e Gjyqtareve dhe vendimin e KGIK-së Nr. 306/2021 të datës 01 nëntor 2021, është në proces të rekrutimit të pesëdhjetë e katër (54) gjyqtareve të rinjë. Plotësimi dhe shtimi i këtyre pozitive në sistemin e drejtësisë, padyshim, do të jetë një masë e dobishme për reduktimin e lëndëve dhe shqyrtimin e tyre në kohë të arsyeshme në pajtim me standardin Kushtetues. Po ashtu lidhur me këtë çështje ju informojmë se gjate këtij viti janë avancuar edhe 13 gjyqtar në Gjykatën e Apelit, 3 gjyqtar në Gjykatën Supreme, si dhe gjate vitit 2022 do të plotësohen edhe 30 pozita të reja me gjyqtare në Gjykatat Themelore të Kosovës.

3. Procesi i rekrutimit të bashkëpunëtoreve profesional

Siç mund të jeni në dijeni, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me Rregulloren nr. 01/901 dt.18.01.2021, ka shpallur konkurs dhe është në proces të rekrutimit të shtatëdhjetë e pesë (75) bashkëpunëtoreve të rinjë, si dhe gjate vitit 2022, do të rekrutoj edhe 50 pozita të reja. Plotësimi i numrit të bashkëpunëtoreve profesional është një proces që derivon edhe nga Ligji për Gjykatat i cili përcakton nevojën që të ketë një bashkëpunëtor profesional për çdo gjyqtarë, i cili proporcional ende nuk është arritur për shkak alokimeve të duhura buxhetore.

4. Rregullimi i kornizës normative që lidhen me normën e gjyqtarëve

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është në proces të ristrukturimit të thellë të kornizës nënligjore për normën gjyqësore të gjyqtarëve ashtu që të stimulohet efikasiteti dhe efektshmëria e gjyqtareve në zgjidhjen e lëndëve në afat të arsyeshëm kohorë në pajtim me standardin kushtetues. Kjo do të bëhet ashtu që mos respektimi i kësaj rregullore dhe rrjedhimisht i normës së kërkuar, do të jetë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore.

Në raport me pikën e dytë të kërkesës suaj, që ka të bëjë me mënyrën e trajtimit të lëndëve kur ato janë bartur nga gjykata jokompetente në gjykatën kompetente, ju njoftojmë që gjyqësori aktualisht, shërbehet me dispozitat në fuqi të ligjeve procedurale të cilat përcaktojnë obligimin e gjykatës/departamentit jo kompetent për ta dërguar lenden në gjykatën/departamentin kompetent.

Më saktësisht këto aspekte, në kontestet civile, qeverisen nga Ligji për Procedurën Kontestimore i cili në nenin 392 përcakton që pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim shpallet jo kompetente dhe lëndën ia dërgon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente për gjykimin e çështjes së ngritur me padi (...).

Sa i përket çështjes së delegimit të lëndëve për kompetencë, një gjë e tillë aktualisht është e rregulluar me Rregulloren Nr. 02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikave të Kosovës, ashtu që nëni 65 paragrafi 3.3 përcakton kërkesën normative që lënda të marrë dhe të mbajë një numër unik identifikues, gjate tërë jetëgjatësisë së saj në sistemin gjyqësor, dhe pavarësisht lëvizjes së lëndës nga një gjykatë në tjetrën.

Në lidhje me këtë, ritheksojmë se, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është në proces të finalizimit të Planit Strategjik. Planifikohet që brenda këtij Plani të qartësohen edhe me tutje situatat që i referohen rasteve kur një lëndë është bartur nga një gjykatë/departament në gjykatën/departamentin tjetër.

Në fund, na lejoni të shtojmë që përgjatë 3 (tre) viteve të fundit KGJK ka ndërmarrë këto veprime dhe ka nxjerre këto akte, të cilat presim që të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në efikasitetin e gjykatave dhe zgjidhjen e lëndëve në kohë të arsyeshme në pajtim me standardin kushtetues:

- 1. Rregullorja Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikave të Kosovës*
- 2. Rregullorja për Autoritetin, Organizimin Dhe Funkcionimin e Njesisë së Inspektimit Gjyqësor*
- 3. Rregulloja (Nr. 08/2019) për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve*
- 4. Kriteret për Shpërndarjen e Lëndëve në Gjykatat e Republikës së Kosovës përmes Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (Smil) dhe Mënyra e Zbatimit të tyre*
- 5. Rregullore Nr. 01/2022 për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore*
- 6. Vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së gjyqtarëve.*

Po ashtu duhet theksuar se në një afat të shkurtër kohor do të funksionalizohet edhe Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Fushë Kosovë për komunën e Fushë Kosovës dhe komunën e Obiliqit, e cila pa dyshim që do të ndikoj në reduktimin e ngarkesës me lëndë në Gjykatat, respektivisht degëve përkatëse të tyre.

Gjithashtu një çështje me rëndësi e cila duhet theksuar është edhe implementimi i Ligjit për Gjykatën Komerciale në një afat rekord, ashtu që KGJK ka ndërmarr të gjitha veprimet adekuate për funksionalizimin e kësaj gjykate.”

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut [e miratuar më 4 nëntor 1950 nga Këshilli i Evropës]

Neni 6 [E drejta për gjykim të drejtë]

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...].

Ligji r. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

KREU III PËRJASHTIMI I GJYQTARIT NGA GJYKIMI

Neni 67

Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:

a) në qoftë se është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo në qoftë se me palën është bashkëkreditör apo bashkëdebtör ose i obliguar për regresim, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;

b) në qoftë se pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo;

c) në qoftë se është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë;

d) në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose te organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit;

e) në qoftë se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së kështillë;

- f) në qoftë se është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi;
- g) në qoftë se ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij.

RREGULLORE NR. 02/2020 PËR ORGANIZIMIN DHE VEPRIM-TARINË E BRENDSHME TË GJYKATAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 65 Numri Unik i Lëndës

1. Për çdo parashtrese e cila krijon rast në gjykatën themelore, sistemi krijon lëndën (rastin).
2. Për çdo lëndë të krijuar në sistem, SMIL krijon numrin unik.
3. Përmbajtja e numrit unik të lëndës:
 - 3.1. viti i pranimit të lëndës (V): viti kur është pranuar lënda
 - 3.2. numri rendor (serik) i lëndës (Nr.): numër gjashtëshifror. Numri serik, për çdo fillim vit rifillon nga zero (0).
 - 3.3. numri unik jepet njëherë nga sistemi dhe nuk ndryshohet gjatë tërë jetëgjatësisë së lëndës në sistemin gjyqësor, pavarësisht lëvizjes së lëndës nga një gjykatë në tjetrën.
4. Numri i lëndës është unik për të gjitha lëmitë dhe të gjitha instancat gjyqësore.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

58. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtguesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
59. Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

60. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

61. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe se konteston tejzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës [C.nr. 256/2018] para Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj dhe Dega në Vushtrri, respektivisht.
62. Gjykata, në vijim rikujton se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij në kuadër të pretendimit për tejzgjatje të procedurës, gjegjësisht të drejtës së tij për zgjidhje të rastit brenda afatit të arsyeshëm kohor të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, pretendon edhe shkelje të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
63. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata nuk e konsideron si të nevojshme trajtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve të lartcekura të Kushtetutës tyre veç e veç, përderisa thelbi i ankesës ka të bëjë me pretendimin për shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, respektivisht me të drejtën për një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm kohor, dhe konsideron se pretendimet e njëjta për shkelje të neneve 21, 22, 23, 24 dhe 46 të Kushtetutës janë të parakohshme, përderisa gjykatat e rregullta nuk kanë marrë vendim përfundimtar lidhur me rastin në fjalë (shih, rastin e Gjykatës, KI127/15, parashtrues *Mile Vasović*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 qershorit 2017, paragrafi 54; dhe KI135/2020, parashtruese *Hava Behxheti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 31 dhjetorit 2020, paragrafi 52).
64. Në kontekst të kriterëve kushtetuese dhe ligjore për (i) shterimin e mjeteve juridike, e përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit; dhe (ii) dorëzimin e kërkesës në afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, Gjykata rikujton se lënda [C.nr.256/2018] është ende duke u shqyrtuar

nga gjykata e shkallës së parë, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike por kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës së tij.

65. Përderisa, përkitazi me pretendimin e tij për moszgjidhje të rastit të tij brenda afatit të arsyeshëm kohor, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata më tej konstaton se parashtruesi i kërkesës ka saktësuar kërkesën e tij ashtu siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
66. Në vijim, Gjykata po ashtu do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriterin e përcaktuar me paragrafin 2 të rregullit 39 [Kriteret e Pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

67. Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *"qartazi e pabazuar"* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si *"pretendime qartazi të pabazuara"*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime *"të shkallës së katërt"*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *"mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes"*; (iii) pretendime *"të pambështetura apo të paarsyetuara"*; dhe në fund, (iv) pretendime *"konfuze dhe të paqarta"*. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *"qartazi të pabazuar"*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *"qartazi të pabazuara"* të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; dhe KI21/21, me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021).
68. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon tejzgjatje të procedurës së zhvilluar të lëndës [C.nr. 256/2018] para Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj dhe procedurës që është duke u zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri nga data e transferimit të kësaj lënde në këtë degë më 20 tetor 2020.
69. Gjykata rikujton se përkitazi me procedurën e zhvilluar para Gjykatës Themelore, Dega në Skenderaj, parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës së tij të parashtruar më 30 qershor 2020 në Gjykatë dhe të regjistruar me numër KI104/20, kishte ngritur pretendim për tejzgjatje të procedurës para kësaj gjykate, përfshirë edhe procedurën e regjistruar me numër të lëndës [C. Nr. 256/2018]. Në lidhje me kërkesën e tij, Gjykata pas vlerësimit të parimeve dhe kritereve të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përmes

Aktvendimit të saj për Papranueshmëri, të 22 marsit 2021, kishte konstatuar se kërkesa e tij është qartazi e pabazuar në bazë kushtetuese ashtu siç është përcaktuar më rregullin 39 (2) të Rregullores së Punës. Më konkretisht, Gjykata kishte vlerësuar se Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj (i) ishte aktive; (ii) nuk kishte qëndruar e heshtur dhe (iii) kishte ndërmarrë veprime njoftuese dhe procedurale për rastin e parashtruesit të kërkesës, dhe rrjedhimisht kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar pretendimin se ecuria e procedurës për vendosjen rreth rastit të tij ka rezultuar në tejzgjatje dhe moszgjidhje të rastit brenda një afati të arsyeshëm kohor.

70. Prandaj, marrë për bazë faktin që Gjykata ka trajtuar çështjen e tejzgjatjes së procedurë para Gjykatës Themelore, Dega në Skenderaj do të trajtojë pretendimin e parashtruesit të kërkesës për tejzgjatje të procedurës së zhvilluar edhe në Degën në Skenderaj, megjithatë në mënyrë specifike do të vendosë theksin në elaborimin e pretendimit të tij për mosmbajtje të seancave dhe zgjidhje të rastit nga ana e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, që nga data e transferimit të lëndës së tij [C.nr. 256/2018] më 8 tetor 2020 për vendosje në këtë degë.
71. Gjykata në vijim, vë në pah se pretendimin e lartcekur të parashtruesit të kërkesës për tejzgjatje të procedurës të zhvilluar do ta trajtojë nga këndvështrimi i të drejtave të garantuara përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke aplikuar edhe parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ, në të cilin rast Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar që *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
72. Në lidhje me të drejtën për nxjerrjen e vendimeve brenda afatit të arsyeshëm kohor, Gjykata i referohet paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, të cilët përcaktojnë që:

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm [...]”.

Neni 6

(E drejta për gjykim të drejtë)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm ...”.

73. Për të vlerësuar bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet e të drejtave dhe lirive kushtetuese që kanë të bëjnë me gjykimin e rasteve brenda afatit të arsyeshëm kohor, Gjykata do të merr në konsideratë parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të

GJEDNJ-së dhe të afirmuara edhe përmes praktikës së Gjykatës. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të pretendimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të merr parasysh: (i) vërtetimin e periudhës së kohëzgjatjes të procedurës në tërësi në institucionet kompetente; (ii) parimet relevante në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave; dhe (iii) arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave para Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Degës në Vushtrri.

(i) Periudha që do të merret parasysh

74. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-se dhe praktikës së saj, ka vlerësuar se përlogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, Aktgjykim, i 23 prillit 1987, paragrafi 64; *Poiss kundër Austrisë*, Aktgjykim, i 23 prillit 1987, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (shih rastin e GJEDNJ-se *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 74 dhe rastin KI177/19, parashtrues NNT "Sokoli", Aktgjykim i 16 prillit 2019, paragrafi 98).
75. Në rastin konkret, Gjykata vëren se më 7 korrik 2015, parashtruesi i kërkesës në kuadër të procedurës kontestimore kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore, Dega në Skenderaj për vërtetim të kufirit (mezhdës) të paluajtshmërisë dhe kërkesën e tij për lirimin e "pronës së uzurpuar" nga ana e palës së paditur, e cila kërkesëpadi në këtë gjykatë ishte regjistruar me numër [C.nr.204/2015]. Kjo procedurë kontestimore ishte ndërprerë përmes Aktvendimit [C.nr.204/2015], të 27 prillit 2017, të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj me arsyetimin se përveç parashtruesit të kërkesës, në këtë procedurë kontestimore ekzistojnë edhe trashëgimtarë tjerë të radhës së parë, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e rastit në procedurë kontestimore. Pas zhvillimit të procedurës jokontestimore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, kjo e fundit përmes Aktvendimit [Ct.nr.33/2018] të 17 majit 2018 kishte konstatuar se përveç parashtruesit të kërkesës palë në këtë procedurë janë edhe dy trashëgimtarë tjerë që kanë interes të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e këtij rasti. Pas përfundimit të procedurës jokontestimore, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj kishte rifilluar procedurën kontestimore dhe lëndën e parashtruesit të kërkesës e kishte regjistruar me numër të ri rendor [C.nr. 256/2018].
76. Ashtu siç është elaboruar më lart, më 8 tetor 2020, si rezultat i aprovimit të kërkesës së gjyqtarit të lëndës A.M për përjashtimin e tij nga kjo lëndë nga ana e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, lënda e parashtruesit të kërkesës i ishte ricaktuar një gjyqtari tjetër për vendosje në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri.
77. Gjykata vë në pah se parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës së tij të regjistruar në Gjykatë me numër KI104/20 kishte pretenduar tejzgjatje të procedurës së zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, e cila përfshinte edhe kërkesëpadinë e regjistruar me numër [C.nr.204/2015]. Gjykata përmes Aktvendimit të saj për Papranueshmëri, të 22 marsit 2021, gjatë

elaborimit dhe vlerësimit të parashtruesit të kërkesës kishte marrë në konsideratë periudhën nga data e parashtrimin [7 korrik 2015] të padisë së tij në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj deri në datën e parashtrimin të kërkesës së tij në Gjykatë [30 qershor 2020]. Ashtu siç është theksuar më lart, Gjykata përmes Aktvendimit të saj për Papranueshmëri në rastin KI104/20 kishte konstatuar se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për moszgjidhje të rastit të tij brenda afatit të arsyeshëm kohor të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së ishte qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese.

78. Gjykata duke iu rikthyer rrethanave të kërkesës së tanishme vëren se pas parashtrimin të kërkesës [KI104/20] së parashtruesit në Gjykatë më 30 qershor 2020, në procedurën e zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, ishin ndërmarrë disa veprime si nga ana e kësaj gjykate, ashtu edhe nga ana e parashtruesit të kërkesës. Më konkretisht, një nga veprimet e ndërmarra nga Gjykata Themelore në Mitrovicë ishte aprovimi i kërkesës së gjyqtarit A.M për përjashtim të tij nga shqyrtimi i rastit të parashtruesit të kërkesës dhe caktimi i gjyqtarit tjetër për vendosje të këtij rasti në degën e kësaj gjykate në Vushtrri.
79. Në rastin konkret, Gjykata marrë për bazë edhe konstatimin e saj përmes Aktvendimit të saj për Papranueshmëri në rastin KI104/20, me rastin e përcaktimit të periudhës kohore që duhet të merret parasysh përkitazi me kërkesën e tanishme, do ta marrë procedurën kontestimore të rifilluar në vitin 2018 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj nga data e regjistrimit të lëndës së parashtruesit të kërkesës me numër rendor [C.nr. 256/2018], si dhe atë të zhvilluar në degën e kësaj gjykate në Vushtrri deri në parashtrimin e kërkesës së tanishme në Gjykatë. Në kuptim të kësaj të fundit, Gjykata vë në pah se kjo është edhe lënda, për të cilën parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tanishme pretendon tejzgjatje të procedurës.

(ii) Parimet relevante

80. Gjykata para së gjithash thekson se, sipas praktikës konsistente gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila është reflektuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përkatësisht kriteret që i referohen: (a) ndërlikueshmërisë së rastit; (b) sjelljes së palëve në procedurë; (c) sjelljes së gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (d) rëndësisë së asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih rastet e GJEDNJ-së, *Mikulić kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 38; *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 6 prillit 2000; *Frydlender kundër Francës*, Aktgjykim i 27 qershorit 2000, paragrafi 43; *Sürmeli kundër Germany*, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006, paragrafi 143; *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 25 qershorit 2019, paragrafi 209). Shih gjithashtu rastet e Gjykatës: KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 shtatorit 2016, paragrafët 53-62; KI23/16, parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 majit 2017, paragrafi 58; KI18/18, parashtrues *Isuf Musliu*,

Aktvendim për papranueshmëri, i 11 qershorit 2018, paragrafi 43; KI13/19, parashtrues *Fevzi Hajdari*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 qershorit 2019, paragrafët 65-72; KI177/19, parashtrues *NNT "Sokoli"*, Aktgjykim i 16 prillit 2019, paragrafët 96-106; KI104/20, parashtrues *Ejup Koci*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 marsit 2021, paragrafi 46; KI135/20, me parashtruese *Hava Behxheti*, cituar më lart, paragrafët 39-54).

(iii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

81. Gjykata vëren se ky rast ka të bëjë me padinë e parashtruesit për vërtetim të kufirit (mezhdës) të paluajtshmërisë dhe vërtetim të asaj nëse pala e paditur ka uzurpuar një pjesë të paluajtshmërisë së parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë.
82. Ashtu siç është elaboruar edhe më sipër, për të konstatuar nëse kohëzgjatja e procedurës ka qenë e arsyeshme, Gjykata duhet të merr parasysh faktorët si në vijim: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e parashtruesit të kërkesës; (c) sjelljen e autoriteteve relevante gjyqësore; dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin e kërkesës në kontest.

a) Ndërlikueshmëria e rastit

83. Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës përmes të cilave ishte theksuar se ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlidhet me çështje të faktit dhe të ligjit por gjithashtu mund të ndërlidhet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së, *Katte Klitschë de la Grange kundër Italisë*, Aktgjykim i 19 shtatorit 1994, paragrafi 55; *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 72; *Humen kundër Polonisë*, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63; shih rastet e Gjykatës, KI18/18, me parashtrues *Isuf Musliu*, cituar më lart, paragrafi 45; dhe KI104/20, parashtrues *Ejup Koci*, cituar më lart, paragrafi 48).
84. Në rastin konkret, Gjykata vëren se rasti i parashtruesit të kërkesës, përveç në procedurë kontestimore, ishte shqyrtuar edhe në procedurë jo-kontestimore për shqyrtimin e trashëgimisë mbi pronën e kontestuar dhe si rezultat i kësaj ishte konstatuar se në lidhje me kërkesëpadinë e tij ishin të përfshirë edhe palë të tjera. Si rrjedhojë e këtij konstatimi në kuadër të procedurës jokontestimore, Gjykata vëren se palë paditëse në këtë procedurë, përveç parashtruesit të kërkesës janë edhe individë të tjerë, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e këtij rasti.
85. Përveç kësaj, kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me pretendimin e tij specifik se një pjesë e paluajtshmërisë së tij është uzurpuar nga pala e paditur. Në këto rrethana, Gjykata duke u bazuar në faktin se kërkesëpadia e tij ndërlidhet me vërtetimin e asaj nëse një pjesë e paluajtshmërisë së tij është uzurpuar, atëherë një pretendim i tillë në parim shqyrtohet përmes dëgjimit të palëve ndërgjyqëse në seanca, daljes në vendngjarje dhe vlerësimit të një ekspertize të mundshme të caktuar nga gjykata. Prandaj, në dritën e këtyre rrethanave, Gjykata konsideron se rasti i

parashtruesit të kërkesës, i cili është në shqyrtim e sipër është mjaftueshëm i ndërlikuar.

(b) Sjellja e parashtruesit të kërkesës

86. Gjykata vë në dukje se parashtruesit në parim kanë të drejtë të ndjekin të gjithë hapat procedural të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Megjithatë, parashtruesit duhet të kenë parasysh, gjithashtu pasojat në rast se mjetet ligjore të shfrytëzuara mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të rastit të tyre. Gjykata konsideron se sjellja e parashtruesve përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin, nëse procedurat vazhduan më gjatë se sa afati i arsyeshëm kohor, i garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së, *McFarlane kundër Irlandës*, Aktgjykim i 10 shtatorit 2010, paragrafin 148; *Eckle kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 82; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KIO7/15, me parashtrues *Shefki Zogiani*, cituar më lart, paragrafi 55).
87. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, disa shembuj të sjelljes së parashtruesit të kërkesës që mund të kontribuojnë në zvarritje të procedurës janë:
- Mungesë e gatishmërisë/vullnetit të palëve në paraqitjen e parashtrësave mund të kontribuojë në ngadalësimin e procedurës (shih rastin *Vernillo kundër Francës*, Aktgjykim, i 20 shkurtit 1991, paragrafi 34);
 - Ndërrimi i shpeshtë i përfaqësuesit ligjor (shih rastin *König kundër Gjermanisë*, Aktgjykim, i 28 qershorit 1978, paragrafi 103);
 - Kërkesa apo mosveprime që kanë ndikim në zhvillimin e procedurës (shih rastin *Acquaviva kundër Francës*, Aktgjykim, i 21 nëntorit 1995, paragrafi 61), ose mungesë e kujdesit për ndjekjen e hapave proceduralë (shih rastin *Keaney kundër Irlandës*, Aktgjykim, i 30 prillit 2020, paragrafi 95);
 - Inicimi gabimisht i një procedurë para një gjykate të cilës i mungon juridiksioni (shih rastin *Beaumartin kundër Francës*, Aktgjykim, i 24 nëntorit 1994, paragrafi 33);
 - sjellje të dëmshme të dëshmuara nga parashtrësja të shumta dhe pretendime të tjera (shih rastin *Pereira da Silva kundër Portugalisë*, Aktgjykim, 22 marsit 2016, paragrafët 76-79).
88. Gjykata duke u bazuar në shkresat e lëndës vëren se parashtruesi i kërkesës ishte më se aktiv me kërkesa të njëpasnjëshme për përsheptim dhe informacion lidhur me statusin e rastit [C.nr.256/18] të tij, të cilat i parashtroi gjatë periudhës së 4 qershorit 2018 dhe 25 gushtit 2021. Ashtu siç është reflektuar edhe në pjesën e fakteve, parashtruesi i kërkesës në kërkesat e tij dorëzuar Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj përveç kërkesës për informacion kishte parashtruar edhe kërkesë për përsheptim të shqyrtimit të rastit të tij nga kjo gjykatë.
89. Më konkretisht, gjatë periudhës së 7 shkurtit 2019 dhe 29 tetorit 2021, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj dorëzoi edhe pesë (5) kërkesa për informacion lidhur me statusin aktual të lëndës së tij.

90. Ndërsa në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri kishte dorëzuar tri (3) kërkesa për përshpejtim dhe informacion në lidhje me lëndën e tij të transferuar për vendosje në këtë degë, respektivisht më 13 prill 2021, 9 gusht 2021 dhe 25 gusht 2021.
91. Gjykata rikujton se më 21 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Gjykatën Themelore në Mitrovicë; te gjyqtari mbikëqyrës të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Skenderaj; dhe te gjyqtari i lëndës A.M., për tejzgjatje të procedurës lidhur me vendosjen e lëndës dhe njëkohësisht kërkoi edhe përjashtimin e gjyqtarit të rastit A.M. nga shqyrtimi i rastit të tij.
92. Për më tepër, Gjykata vë në pah faktin se si rezultat i kërkesës fillestare të parashtruesit të kërkesës për përjashtim të gjyqtarit A.M, ky i fundit te Kryetari i Gjykatës Themelore kishte parashtruar kërkesë për përjashtimin e tij nga ky rast. Si rezultat i kësaj kërkesë të gjyqtarit A.M me Aktvendim të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, lënda [C.nr.256/2018] i ishte caktuar gjyqtarit B.F për shqyrtim në një degë tjetër të kësaj gjykate, respektivisht, Degën në Vushtrri, që nënkupton shqyrtim të lëndës prej fillimit nga ana e gjyqtarit të ri.
93. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata rikujton arsyetimin e dhënë përmes Aktvendimit [GJA.nr.5/2020] të 8 tetorit 2020 të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, përmes të cilit vendim ishte aprovuar kërkesa gjyqtarit A.M, për përjashtim të tij nga shqyrtimi i rastit [C.nr.256/2018] dhe ishte vendosur që kjo lëndë t'i caktohet gjyqtarit tjetër B.F në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri. Në këtë Aktvendim, ndër tjerash theksohet se:
- “Gjyqtar i çështjes [A.M] me datë 27.10.2020 ka dhënë deklaratë, duke konsideruar se kërkesa e [parashtruesit të kërkesës] për përjashtimin e tij nga kjo lëndë është e pabazuar pasi që pretendimet e cekura nga paditësi nuk qëndrojnë, mirëpo duke marrë parasysh dyshimin e [parashtruesit të kërkesës] i cili nga vetja ka formuar bindje i propozon Kryetarit të Gjykatës që ti ketë parasysh pretendimet e [parashtruesit të kërkesës] me qëllim të eliminimit të dyshimit të tij, andaj në bazë të dispozitave të nenit 67 par. (g) të LPK-së konsideron se janë plotësuar kushtet për përjashtimin nga kjo lënd.”*
94. Në vijim, Kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, përmes Aktvendimit të lartcekur kishte konstatuar se: *“ [parashtruesi i kërkesës] ka krijuar bindje se gjyqtari i çështjes nuk po procedon lëndën pasi që i njëjti ka paraqitur shqetësime lidhur me tejzgjatjen e procedurës për vendosjen e kësaj lënde nga ky gjyqtari çështjes, e kjo vërtetohet edhe nga deklaratat e gjyqtarit, andaj Kryetari i gjykatës i vlerëson se plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenit 67 par. (g) të LPK-së, që i njëjti të përjashtohet nga procedimi i mëtejme i kësaj lënde, e krejt kjo me qëllim të eliminimit të të gjitha dyshimeve të parashkruar nga [parashtruesi i kërkesës], dhe kjo lënd ti ndahet ndonjë gjyqtari tjetër e në rastin konkret gjyqtarit [B.F.]”*

95. Lidhur me veprimet procedurale të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së ku kishte sqaruar se parashtruesit e kërkesës i kërkohej të tregojë kujdes në ndërmarrjen e hapave procedural dhe për t'u përmbajtur nga përdorimi i taktikave të vonimit të shqyrtimit të rastit të tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, *Union Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës*, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35).
96. Në vijim dhe bazuar në veprimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës që nga data e rifillimit të procedurës kontestimore në vitin 2018 deri në ditën e parashtrimit të kërkesës së tij të tanishme në Gjykatë [11 tetor 2021], Gjykata konsideron se veprimet e tilla procedurale mund të kenë ndikuar në vonesën e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në Degën në Skenderaj dhe në Degën në Vushtrri respektivisht në shqyrtimin e rastit të tij në merita.

(c) Sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore

97. Gjykata fillimisht vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, Aktgjykim i 1 prillit 2014, paragrafi 91; *Abdoella kundër Holandës*, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24, *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, Aktgjykim, i 7 dhjetorit 2010).
98. Në këtë kontekst, GJEDNJ kishte theksuar se nuk mund të merret në konsideratë arsyetimi i gjykatave për mbingarkesën me lëndë të pazgjidhura (shih rastet e GJEDNJ-së, *Vocaturò kundër Italisë*, GJEDNJ, Aktgjykim i 1 prillit 1989, paragrafi 17; dhe *Cappello kundër Italisë*, Aktgjykim i 24 janarit 1992, paragrafi 17). GJEDNJ, megjithatë kishte theksuar se mbingarkesa e përkohshme e rasteve nuk përfshin përgjegjësinë e shteteve kontraktuese, me kushtin që ato, me shpejtësinë e domosdoshme, ndërmarrin veprime korrigjuese të përballen me një situatë të tillë të veçantë (shih rastet e GJEDNJ-së *Buchholz kundër Gjermanisë*, Aktgjykim, i 6 majit 1981, *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, Aktgjykim, i 13 korrikut 1983, paragrafi 29).
99. Në vijim, GJEDNJ ka specifikuar se: “Metodat që mund të konsiderohen, si të përshtatshme dhe përkohshme, përfshijnë zgjedhjen për të trajtuar rastet sipas një radhe të veçantë, bazuar jo vetëm në datën kur ato janë parashtruar, por duke marrë në konsideratë shkallën e tyre të urgjencës dhe të rëndësisë dhe, në veçanti, në atë që është në rrezik për palët e interesuara” (shih rastin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, i cituar më lart, paragrafi 29).
100. Gjykata po ashtu edhe përmes praktikës së vet gjyqësore ka theksuar se gjykatat e rregullta kanë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor, që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm kohor, në mënyrë që të mos shkaktojnë huti dhe pasiguri. Gjykatat e rregullta nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra. Përndryshe, besimi i publikut ndaj tërë rendit juridik do të minohej (shih në lidhje me këtë arsyetimin e Gjykatës në rastin KI104/20, paragrafi 62).

101. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega Skenderaj pas parashtrimin të kërkesës së tij KI104/20 kishte komunikuar (i) duke e njoftuar parashtruesin lidhur me pasojat juridike në rast të mospagesës së taksës gjyqësore lidhur me kërkesën e tij për përjashtim të gjyqtarit, (ii) duke liruar parashtruesin e kërkesës nga taksa gjyqësore si dhe në fund (iii) duke aprovuar kërkesën e gjyqtarit të A.M. për përjashtimin e tij nga lënda [C.nr.256/18] dhe (iv) transferuar lëndën te një gjyqtar tjetër në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri.
102. Megjithatë, Gjykata vë në pah faktin se Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, prej momentit të pranimit të rastit [C.nr.256/18] më 8 tetor 2020 deri në dorëzimin e përgjigjes së saj në Gjykatë më 12 nëntor 2021, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural për shqyrtimin e këtij rasti. Mosveprimet e saj deri në parashtrimin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatë, përfshijnë periudhën në kohëzgjatje prej një (1) viti e katër (4) ditëve.
103. Lidhur me mosveprimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri, Gjykata i referohet përgjigjes së gjyqtarit mbikëqyrës të kësaj dege, i cili mungesën e seancave shqyrtuese dhe kohëzgjatjen e shqyrtimit të rastit [C.nr.256/2018] e justifikon me mbingarkesë të lëndëve të pazgjidhura, konkretisht me rreth një mijë e gjashtë qind e dyzet e shtatë (1647) lëndë, dhe se i njëjti për momentin është duke i trajtuar të njëjtat sipas radhës që nga viti 2014.
104. Megjithatë, në njoftimin e tij, gjyqtari i mbikëqyrës A.M, e njofton Gjykatën se duke filluar nga marsi i vitit 2022, priten të fillojnë punën në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri edhe dy gjyqtarë të rinj që janë në fazën e trajnimit fillestar në fushën civile.
105. Në vijim, Gjykata i referohet edhe përgjigjes së KGJK-së, e cila ndaj pyetjes së Gjykatës se *“Cila është strategjia apo veprimet e ndërmarra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës përkitazi me shqyrtimin e lëndëve para gjykatave të rregullta brenda një afati të arsyeshëm kohor, garanci kjo e përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, është përgjigjur se KGJK trajtimin e kësaj çështjeje do ta adresojë përmes Planit Strategjik 2022-24 dhe rregullativës së brendshme ligjore. Më tej, KGJK njoftoi Gjykatën se i njëjti është në proces: (i) të rekrutimit të pesëdhjetë e katër (54) gjyqtarëve të rinj; dhe (ii) bashkëpunëtorëve profesionale; si dhe (iii) të ristrukturimit të “thellë të kornizës nënligjore për normën gjyqësore të gjyqtarëve ashtu që të stimulohet efikasiteti dhe efektshmëria e gjyqtareve në zgjidhjen e lëndëve në afat të arsyeshëm kohor në pajtim me standardin kushtetues.”*
106. Megjithatë, KGJK në përgjigjen e tij pohon që në tri vitet e fundit ka miratuar aktet nënligjore, të cilat synojnë që të ngritin efikasitetin e shqyrtimit të lëndëve nga gjykata e rregullta. Këto akte nënligjore sipas KGJK-së përfshijnë: (i) Rregullorja Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës; (ii) Rregullorja për Autoritetin, Organizimin Dhe Funksionimin e Njësisë së Inspektimit Gjyqësor; (iii) Rregullorja (Nr. 08/2019) për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve; (iv) Kriteret për Shpërndarjen e Lëndëve në Gjykatat e Republikës së Kosovës përmes Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve

(Smil) dhe Mënyra e Zbatimit të tyre; dhe (v) Rregullore Nr. 01/2022 për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore.

107. Ndërsa, ndaj pyetjes specifike të Gjykatës se: *“Bazuar në rregullat apo procedurat e përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, specifikisht në kuptim të përcaktimit të radhës së shqyrtimit të rasteve të regjistruara në gjykatat e rregullta, si trajtohet çështja e radhës së shqyrtimit të lëndëve, të cilat më vendim të gjykatës përkatëse transferohen për shqyrtim dhe gjykim nga një degë e Gjykatës në degën tjetër të gjykatës së njëjtë”* KGJK u përgjigj se kjo çështje është e rregulluar me Rregulloren e KGJK-së Nr. 02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikave të Kosovës, e cila me nenin 65, paragrafin 3.3 përcakton që lënda merr dhe mban një numër unik identifikues, gjatë tërë jetëgjatësisë së saj në sistemin gjyqësor, dhe pavarësisht lëvizjes së lëndës nga një gjykatë në tjetrën. Në vijim të kësaj, KGJK po ashtu specifikoi se: *“Planifikohet që brenda këtij Plani [Strategjik të KGJK-së] të qartësohen edhe me tutje situatat që i referohen rasteve kur një lëndë është bartur nga një gjykatë/departament në gjykatën/departamentin tjetër.”*
108. Bazuar në këtë, Gjykata vëren se lënda [C.nr.256/18] e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri është transferuar nga Dega në Skenderaj me po këtë numër të lëndës. Në këtë kuptim, bazuar në përgjigjen e KGJK-së i bie që kjo lëndë në Degën në Vushtrri të trajtohet sipas radhës së numrit të lëndës të regjistruar në vitin 2018.
109. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata konsideron se çështja e zgjidhjes së rasteve nga ana e gjykatave të rregullta brenda një afati të arsyeshëm kohor kërkon një adresim dhe zgjidhje më të përshtatshme dhe emergjente nga ana e KGJK-së, e cila në praktikë duhet që të dëshmojë se procesi i ndërmarrë nga ky i fundit ka rezultuar në përmirësimin e mbingarkesës së gjykatave. Në vijim, Gjykata konsideron se çështja e zgjidhjes së rasteve nga gjykatat e rregullta brenda një afati të arsyeshëm kohor, e garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës kërkon veprime dhe adresim më të përshpejtuar se veprimet e ndërmarra të reflektuara në përgjigjen e KGJK-së, të 7 marsit 2022. Në dritën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata po ashtu vlerëson se një reformë e tillë e nisur nga ana e KGJK-së që synon përshpejtimin e shqyrtimit të lëndëve nuk do të mund të justifikonte vonesat sepse i takon këtij organi që të organizojë hyrjen në fuqi të kësaj reforme dhe zbatimin e saj në mënyrë që të mos zgjasë shqyrtimi i çështjeve ende të pazgjidhura (shih në mënyrë analoge rastin e GJEDNJ-së *Fisanotti kundër Italisë*, Aktgjykim, i 23 prillit 1998, paragrafi 22).
110. Megjithatë, Gjykata duke iu rikthyer rrethanave të rastit konkret dhe bazuar: (i) në përgjigjen e KGJK-së se rregullativa e brendshme e saj parasheh që lënda e parashtruesit të kërkesës do të trajtohet sipas radhës apo numrit rendor [C.nr.256/18]; dhe (ii) në përgjigjen e gjyqtarit mbikëqyrës të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri se nga marsi i vitit 2022 në këtë degë do të fillojnë punën edhe dy gjyqtarë të rinj konsideron se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë ndërmarrë veprime të nevojshme që rasti i tij të shqyrtohet dhe trajtohet nga kjo gjykatë.

111. Në këtë kuptim, Gjykata megjithatë konsideron se gjatë shqyrtimit të lëndës së parashtruesit të kërkesës nga ana e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri kjo e fundit duhet të ndërmerr veprime konkrete që bazuar në shkresat e lëndës të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse kërkesëpadia apo lënda e parashtruesit të kërkesës në këtë gjykatë përbën rast i cili duhet të trajtohet me një urgjencë më të shpejtë.

(d) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest

112. Lidhur me kriterin e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila sqaron se një kategori e rasteve kërkon zgjidhje të veçantë ekspeditive. Sipas kësaj praktike, shembuj që kërkojnë kujdes të veçantë dhe zgjidhje me prioritet janë rastet që ndërlidhen me statusin dhe kapacitetin civil, rastet rreth kujdestarisë së fëmijëve dhe marrëdhënies prind-fëmijë, kontestet nga marrëdhënia e punës, rastet e parashtruesve që vuajnë nga “sëmundje të pashërueshme” dhe kanë “pritje të reduktuar të jetëgjatësisë”, si dhe rastet rreth të drejtës për arsim (shih rastet e GJEDNJ, *Bock kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 21 shkurtit 1989, paragrafi 49; *Laino kundër Italisë*, Aktgjykim i 18 shkurtit 1999, paragrafi 18, *Mikulić kundër Kroacisë*, i cituar më lart, paragrafi 44; *Hokkanen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 23 shtatorit 1994, paragrafi 72; *Niederböster kundër Gjermanisë*, Aktgjykim i 27 majit 2003, paragrafi 39, *Frydlender kundër Francës*, i cituar më lart, paragrafi 45, *Vocaturò kundër Italy*, i cituar më lart, paragrafi 17; *X kundër Francës*, Aktgjykim i 31 marsit 1992, paragrafi 47; *A. dhe të tjerët kundër Danimarkës*, Aktgjykim i 22 janarit 1996, paragrafët 78-81, *Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, Aktgjykim i 16 marsit 2010, paragrafi 109).
113. Gjykata rikujton që kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me padinë e tij për vërtetim të kufirit (mezhdës) të paluajtshmërisë dhe vërtetim të asaj nëse një pjesë e paluajtshmërisë së tij është uzurpuar nga pala e paditur. Ashtu siç është specifikuar edhe më lart është në diskrecionin edhe të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri që të shqyrtohet nëse kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës është e një rëndësie të konsiderueshme që kërkon urgjencë të veçantë nga ana e kësaj gjykate.

Përfundim

114. Si përfundim, Gjykata gjen se kohëzgjatja e procedurës pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Skenderaj dhe kohëzgjatja e procedurës pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri përkitazi me shqyrtimin e lëndës [C.nr. 256/2018] të parashtruesit të kërkesës nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme.
115. Rrjedhimisht, në dritën e kriterëve të lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të afirmuara edhe përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës përkitazi me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata gjen se pretendimi i parashtruesit të kërkesës lidhur me tejzgjatjen e procedurës dhe moszgjidhjen e rastit brenda një afati të arsyeshëm të lëndës [C.nr. 256/2018], është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes” dhe duhet

të deklarohet i papranueshëm në pajtim me paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 30 mars 2022, me shumicë votash,

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka - Nimani